



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.145

1 nëntor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 330
datë 14.10.2010

Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në memorandumun e mirëkuptimit për organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe plotësimin me personel të Qendrës së Përbashkët të Informacionit (Intelligence Fusion Centre-IFC)..... 7813

Vendim i KM
nr.836, datë 21.10.2010

Për një shtesë në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar 7835

LIGJ
Nr.10 330, datë 14.10.2010

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MEMORANDUMIN E MIRËKUPTIMIT
PËR ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË, FINANCIMIN DHE PLOTËSIMIN ME
PERSONEL TË QENDRËS SË PËRBASHKËT TË INFORMACIONIT (INTELLIGENCE FUSION
CENTRE - IFC)**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në memorandumin e mirëkuptimit për organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe plotësimin me personel të Qendrës së Përbashkët të Informacionit (Intelligence Fusion Centre - IFC), bërë më 5 tetor 2006.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6736, datë 21.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET DEPARTAMENTIT TË MBROJTJES TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË MBRETËSISË SË BELGJIKËS, DHE DEPARTAMENTIT TË MBROJTJES KOMBËTARE TË KANADASË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË ÇEKISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË ESTONISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË REPUBLIKËS FRANCEZE, DHE MINISTRISË FEDERALE TË MBROJTJES SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS HELENE, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË HUNGARISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË ITALISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË LETONISË DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË LITUANISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË NORVEGJISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË POLONISË, DHE MINISTRIT TË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË PORTUGALISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES KOMBËTARE TË RUMANISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SLOVAKISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SLOVENISË, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË SPANJËS, DHE SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS TURKE, DHE MINISTRISË SË MBROJTJES TË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT, DHE SHTABIT SUPREM, FORCAT ALEATE TË EUROPËS (SHAPE), LIDHUR ME ORGANIZIMIN, ADMINISTRIMIN, SIGURINË, FINANCIMIN DHE PLOTËSIMIN ME PERSONEL TË QENDRËS SË PËRBASHKËT TË INFORMIMIT (INTELLIGENCE FUSION CENTRE-IFC)

Hyrje

Ministri i Mbrojtjes i Mbretërisë së Belgjikës, Departamenti i Mbrojtjes Kombëtare të Kanadasë, Ministria e Mbrojtjes e Republikës Çeke, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Estonisë, Ministri i Mbrojtjes i Republikës Franceze, Ministri Federal i Mbrojtjes i Republikës Federale të Gjermanisë, Ministria e Mbrojtjes Kombëtare Helene, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Hungarisë, Ministria e Mbrojtjes e Republikës Italiane, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Letonisë, Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Lituanisë, Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Norvegjisë, Ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Polonisë, Ministri i Mbrojtjes e Republikës së Portugalisë, Ministria e Mbrojtjes Kombëtare të Rumanisë, Ministria e Mbrojtjes të Republikës së Sllovaqe, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Sllovenisë, Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Spanjës, Shtabi i Përgjithshëm i Republikës Turke, Departamenti Mbrojtës i SHBA, Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Shtabi Suprem i Forcave Aleate të Europës (SHSFAE), në këtë dokument të referuar bashkërisht si “Nënshkruesit”,

duke pasur parasysh që, në mbështetje të Traktatit të Atlantikut të Veriut, nënshkruesit dëshirojnë të bashkojnë përpjekjet e tyre për mbrojtje të përbashkët në një bashkëpunim më të ngushtë;

duke marrë në konsideratë dispozitat e marrëveshjes ndërmjet palëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut lidhur me statusin e forcave të tyre (NATO SOFA), të nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951 dhe Protokollit mbi Statusin e Shtabeve të Përgjithshme Ushtarake Ndërkombëtare, të ngritur në vijim të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, të nënshkruar në Paris më 28 gusht 1952 (Protokolli i Parisit);

duke pasur parasysh që në Pragë në nëntor 2002, kryetarët e shteteve dhe qeverive të Aleancës ranë dakord mbi nevojën për të forcuar më tej NATO-n, me qëllim përballimin e rreziqeve të reja dhe sfidave të sigurisë të shekullit 21. Për rrjedhojë, takimi jozyrtar i ministrave të mbrojtjes në Colorado Springs në tetor 2003, dhe komandantët e forcës së NATO-s në Allied Reach 2004 nxorën në pah pamjaftueshmërinë e informimit të NATO-s (ushtarake) në nivele politike dhe urdhëruese. Në veçanti, operacionet aktuale dhe

nevojat për informim për forcën reaguese të NATO-s, dhe forcat e përbashkëta vepruese tregojnë nevojën për kapacitete shtesë për analizë shtesë të informimit;

duke pranuar që shkëmbimi i informimit do t'u nënshtrohet autoriteteve kombëtare të pjesëmarrëse dhe që përgjegjësitë e shkëmbimit të informimit të NATO-s do të realizohen siç përcaktohen në MC 128 (Udhëzuesi i politikave për informimin e NATO-s) dhe MC 167. Kontributet kombëtare mbeten burimi kryesor i informimit të NATO-s duke nxjerrë në pah rëndësinë e mbështetjes nga ana e vendeve anëtare të NATO-s;

duke vërejtur se NATO MC 534 u miratua nga ana e Komitetit Ushtarak dhe u njoh nga ana e NAC si koncepti i Qendrës së Përbashkët të Informimit (Intelligence Fusion Centre-IFC); dhe realizimin e marrëveshjes teknike lidhur me komandën dhe kontrollin e Qendrës së Përbashkët të Informimit nga ana e NATO-s;

duke vërejtur se Shtetet e Bashkuara, si shtet kuadër, do të sigurojë pajisje dhe ambientet fillestare për krijimin e Qendrës së Përbashkët të Informimit (Intelligence Fusion Centre-IFC);

me dëshirën për të realizuar një organizim, administrim, plotësim me personel, mbrojtje dhe marrëveshje financiare të tilla ndërkombëtare siç nevojiten për krijimin dhe operimin e Qendrës së Përbashkët të Informimit (Intelligence Fusion Centre-IFC) si shtabi ushtarak ndërkombëtar i NATO-s dhe i përgjigjet kërkesave të Shtabit Suprem të Forcave Aleate të Europës (Supreme Headquarters Allied Powers Europe-SHAPE);

duke marrë në konsideratë C-M (2002) 49 (Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut), të datës 17 qershor 2002;

prandaj, nënshkruarit kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

Seksioni 1 Përcaktime

Përveçse kur specifikohet një kuptim brenda këtij memorandumi mirëkuptimi dhe në dokumentacionin e tij pasues, aplikohet fjalori i termave dhe përcaktimeve të NATO-s (AAP-6) dhe përcaktimet e formuluar në publikimin e praktikave të përvetësimit Aleat/Allied Acquisition Practices Publication (AACP-1), pjesa I (udhëzime dhe dispozita model për memorandumet e mirëkuptimit). Përveç çdo termi të përcaktuar në dispozita të tjera të këtij memorandumi mirëkuptimi, termat e mëposhtëm do të mbartin këto kuptime, kur përdoren në këtë memorandum dhe dokumentacionin e tij pasues:

1.1 “Shteti aplikant” nënkupton një vend anëtar të NATO-s, i cili kërkon të marrë pjesë në Qendrën e Përbashkët të Informimit (Intelligence Fusion Centre-IFC) duke pranuar dispozitat e këtij memorandumi mirëkuptimi dhe konfirmuar angazhimin në të ardhmen me plotësimin me personel, financimin dhe mbështetjen e IFC-së.

1.2 “Të dhëna të klasifikuara” nënkuptojnë të dhëna zyrtare, të cilat duhet të ruhen në interes të NATO-s dhe/ose sigurisë kombëtare të pjesëmarrësit dhe që përcaktohen në mënyrë të tillë nga zbatimi i shenjave të klasifikimit të sigurisë.

1.3 Përgjegjësi i IFC-së mbetet këshilltari kryesor për Shtabin Suprem të Forcave Aleate të Europës (Supreme Headquarters Allied Powers Europe –SHAPE).

1.4 “Të dhëna të kontrolluara të paklasifikuara” nënkuptojnë të dhëna të paklasifikuara të pjesëmarrësit, ndaj të cilit janë aplikuar kufizime për shpërndarjen dhe përdorimin, në përputhje me legjislacionin, politikat dhe rregulloret kombëtare të pjesëmarrësit në fjalë.

1.5 “Persona në ngarkim” nënkuptojnë persona të përcaktuar sipas nenit 1, paragrafi 1 (c) të NATO SOFA.

1.6 “Shteti kuadër” nënkupton pjesëmarrësin përgjegjës për organizimin e një mbështetjeje të caktuar siç specifikohet në këtë memorandum mirëkuptimi. Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbeten shteti kuadër për Qendrën e Përbashkët të Informimit (Intelligence Fusion Centre-IFC).

1.7 “Pala kuadër” nënkupton shtabin që koordinon mbështetjen ndaj Qendrës së Përbashkët të Informimit (Intelligence Fusion Centre-IFC)

1.8 “Qendra e Përbashkët e Informimit (Intelligence Fusion Centre-IFC)” nënkupton Shtabin Ushtark Ndërkombëtar për IFC në mbështetje të NATO-s, të vendosur në Molesworth, Britani e Madhe.

1.9 “Shteti pritës” nënkupton pjesëmarrësin, në territorin sovran të të cilit është lokalizuar IFC. Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut është shteti pritës për IFC.

1.10 “Të dhëna” nënkuptojnë çdo komunikim, marrje njohurish apo informim, pavarësisht nga forma apo lloji, përfshirë ato të natyrës shkencore dhe teknike, dhe gjithashtu ato që përfshijnë fotografi, raporte përfundimtare apo paraprake, manuale, të dhëna kërcënuese, të dhëna eksperimentale, teste, projekte, specifikime, procese, teknika, shpikje, skica, program kompjuterik (software), përfshirë kodin e burimit, shkrime teknike, regjistrime me zë, prezantime të ilustruara dhe prezantime të tjera grafike, qofshin në shirit manjetik, memorie kompjuteri, ose në çdo formë tjetër që i nënshtrohen apo jo të drejtës së autorit, të drejtës së patentës, apo çdo mbrojtjeje tjetër ligjore.

1.11 “Elementi mbështetës kombëtar” nënkupton çdo njësi kombëtare të atashuar pranë IFC-së, të krijuar me qëllim mbështetjen e anëtarëve kombëtarë të IFC-së.

1.12 “Pjesëmarrës” nënkupton departamentet/ministritë përkatëse të mbrojtjes të shteteve anëtare të NATO-s, të cilët kanë dhënë pëlqimin e tyre për t’u përfaqësuar në IFC me personel dhe mbështetje financiare kundrejt IFC-së, në përputhje me dispozitat e këtij memorandum mirëkuptimi.

1.13 “Përfaqësuesi i lartë kombëtar (PLK)” nënkupton oficerin e lartë të çdo pjesëmarrësi në IFC.

1.14 “Komiteti i Lartë i Politikave dhe Burimeve (KLPB)” nënkupton organizmin e përbërë nga përfaqësues të nënshkruesve i cili është përgjegjës për aprovimin e buxhetit shumëkombësh, plotësimin me personel dhe çdo çështje tjetër që del në bazë të këtij memorandum mirëkuptimi dhe operimi i IFC-së.

1.15 “Nënshkruesit” nënkuptojnë pjesëmarrësit dhe Shtabin Suprem të Forcave Aleate të Europës (Supreme Headquarters Allied Powers Europe-SHAPE).

Seksioni 2

Qëllimi dhe fusha e veprimit

2.1 Qëllimi i këtij memorandum mirëkuptimi është vendosja e parimeve për organizimin, administrimin, sigurinë, financimin dhe plotësimin me personel të IFC-së, si dhe për ndarjen e buxhetit shumëkombësh ndërmjet pjesëmarrësve.

2.2 Fusha e veprimit të këtij memorandum mirëkuptimi bazohet në nevojën për të plotësuar kërkesat për informim të NATO-s dhe aftësitë për të planifikuar dhe zbatuar operacionet në përputhje me MC 0534. Këto operacione përfshijnë ato për të cilat janë identifikuar forcat e dislokuara dhe operacionet për të cilat forcat pritet të identifikohen. Ky memorandum mirëkuptimi aplikohet në mënyrë të barabartë për misionet aktuale dhe stërvitjet në të cilat merr pjesë IFC-ja.

Seksioni 3

Misioni dhe marrëveshjet e komandës

3.1 IFC do të sigurojë për Komandantin Suprem Aleat të Europës (Suprem Allied Commander Europe-SACEUR) informim në kohën e duhur, efikas, të mundësuar nga një rrjet i plotë në mbështetje të planifikimit dhe zbatimit të operacioneve, veçanërisht operacioneve NRF dhe CJTF.

3.2 Marrëdhëniet e komandës, që i japin mundësi IFC të realizojë detyrat e saj në kohë paqeje, krize dhe gjatë operacioneve, përcaktohen sipas dispozitës së një marrëveshjeje teknike të rënë dakord ndërmjet USEUCOM dhe Shtabit Suprem të Forcave Aleate të Europës (Supreme Headquarters Allied Powers Europe-SHAPE), në vijim të konsultimit të SHAPE-s me shtetet.

3.3 Të gjitha marrëveshjet ekzistuese të NATOS-s për shkëmbimin e informacionit, përfshirë marrëveshjet gjeohapësinore, mbeten të pandryshuara nga ky memorandum mirëkuptimi. Shtetet inkurajohen të shkëmbejnë informacion me IFC-në sipas prioriteteve të vendosura nga SHAPE. Secili shtet i siguron të dhëna të tilla nëpërmjet mënyrave më të shpejta të mundshme pa prituri për kërkesa të veçanta. Secili shtet gjithashtu mund të ndërmarrë masa për të mbrojtur burimet dhe metodat e tij të informimit. Pjesëmarrësve mund t’u sigurohen ambiente kombëtare, në mënyrë që të krijojnë lidhjen kombëtare, nëse është e

nevojshme. Nxjerrja e të dhënave të klasifikuara të NATO-s nga IFC për shtete dhe organizata që nuk janë anëtare të NATO-s realizohet sipas MC 167/3 dhe CM (2002) 49, përfshirë direktivat mbështetëse.

Seksioni 4 **Baza ligjore dhe rregullatore**

Dokumentacioni dhe legjislacioni i mëposhtëm dhe çdo ndryshim pasues i tyre aplikohet për statusin dhe aktivitetet e IFC-së, anëtarëve të saj dhe personave në ngarkim sipas nevojës:

4.1 Marrëveshja ndërmjet palëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut lidhur me statusin e forcave të tyre (NATO SOFA), të nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951;

4.2 Mbas aktivizimit si Shtabi Ushtarak Ndërkombëtar (SHUN) nga ana e Këshillit të Atlantikut të Veriut, protokollin mbi statutin e SHUN, të hartuar sipas NATO-s të nënshkruar në Paris më 28 gusht 1952 (Protokolli i Parisit).

4.3 MC 128, Udhëzuesi i politikave mbi informimin e NATO-s;

4.4 MC 167, Nxjerrja e të dhënave të klasifikuara dhe të paklasifikuara të NATO-s për shtete dhe organizata joanëtare të NATO-s;

4.5 CM (2002) 49, siguria brenda NATO-s;

4.6 MC 317, struktura e forcave të NATO-s;

4.7 MC 534, Qendra e Përbashkët e Informimit (Intelligence Fusion Centre-IFC);

4.8 Memorandumi i mirëkuptimit nuk ka për qëllim të cenojë ligjet kombëtare të pjesëmarrësve apo ndonjë ligj ndërkombëtar.

Seksioni 5 **Përgjegjësitë**

5.1 Shteti kuadër do të sigurojë mbështetje për IFC-në sipas aneksit A.

5.2 Anëtarët e personelit të IFC-së dhe anëtarët e pjesëmarrësve të caktuar pranë çdo strukture kombëtare mbështetëse, do të paguhet nga pjesëmarrësit që i sigurojnë, së bashku me çdo kuotë të pagueshme sipas rregulloreve të tyre kombëtare.

5.3 Secili pjesëmarrës do të caktojë për IFC-në, personel të kualifikuar teknikisht dhe fizikisht sipas përshkrimit të vendit të punës për të plotësuar secilin nga pozicionet e përcaktuara për ta. Shpërndarja e personelit do të realizohet sipas strukturës dhe procedurave të skicuara në aneksin B të këtij memorandumi mirëkuptimi.

5.4 Pala kuadër do të koordinojë mbështetjen për Qendrën e Përbashkët të Informimit/Intelligence Fusion Centre-IFC.

5.5 Kundërinformimi i Komandës Aleate/Allied Command Counter Intelligence ACCI-së do të sigurojë asistencë kundërinformuese në lidhje me të gjithë personelin e IFC-së sipas AD 65-3.

5.6 Përgjegjësi i IFC-së është përgjegjës për përmbushjen e misionit, detyrave dhe administrimit të IFC-së sipas dispozitave të aneksit D.

Seksioni 6 **Disiplina dhe detyrat kombëtare**

6.1 Përsa i përket disiplinës dhe detyrave kombëtare, administrimi i anëtarëve të personelit të IFC-së do të ndjekë procedurat e direktivës ACO 45-1.

6.2 Përfaqësuesi i lartë kombëtar ose delegatët e tyre mbajnë, përsa i përket personelit të tyre, të gjitha kompetencat e akorduara nga ligjet dhe rregulloret kombëtare, konform Protokollit të Parisit dhe NATO SOFA. Ata sigurojnë që, brenda kufizimeve të parashikuara nga ligjet dhe rregulloret e tyre përkatëse, personeli i tyre të pajtohet me rregulloret e lëshuara nga ana e përgjegjësit të IFC-së.

6.3 Anëtarët e personelit të Qendrës së Përbashkët të Informimit/Intelligence Fusion Centre-IFC do të kryejnë detyra sipas udhëzimeve të përgjegjës të IFC-së, në përputhje me misionin e IFC-së. Detyrat në fjalë do të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar të pjesëmarrësve.

Seksioni 7

Plotësimi me personel

7.1 Secili pjesëmarrës do të caktojë pranë IFC-së personelin e nevojshëm për të plotësuar pozicionet e përcaktuara për të. Kërkesat për certifikata sigurie, aftësia gjuhësore, kualifikimet profesionale dhe kategoria për pozicionet konform AD 45-1 do të përshkruhen sipas procedurave të aneksit B. Për më tepër, AD 45-1 specifikon që periudha normale e detyrës të jetë 3 vjet. Përjashtimet nga ky udhëzim përcaktohen nga kapitulli 3 i direktivës së lartpërmendur.

7.2 Marrëveshjet informale me shkrim ndërmjet IFC-së dhe çdo pjesëmarrësi të interesuar, mund të lejojnë ndryshime ndaj përcaktimit të detyrës së miratuar, përveçse atyre që ndikojnë mbi nivelet e personelit dhe përcaktimet kundrejt shteteve të caktuara.

7.3 Kërkesat për shtesa ose reduktime të përcaktimeve të posteve, si dhe ndryshimet në përshkrimin e detyrës, do të merren në konsideratë nga ana e SPRC-së në bazë vjetore në përputhje me procedurat e aneksit B.

7.4 Para fillimit të periudhës së detyrës së anëtarit të personelit të IFC-së, pjesëmarrësi njofton përgjegjës të IFC-së mbi organizatën/at përkatëse, të cilat do të ushtrojnë kontroll operacional kombëtar dhe sigurojnë mbështetje administrative për anëtarin e personelit të IFC-së të pjesëmarrësit.

7.5 Sipas AD 45-1, anëtarët e personelit të IFC-së lejohen të marrin pushime sipas autorizimit/lejimit nga ana e pjesëmarrësit. Pjesëmarrësi i siguron përgjegjës të IFC-së një listë me pushimet për t'u respektuar.

7.6 Përgjegjësi i IFC-së dhe rrjeti i komandës së IFC-së mbikëqyr ditë pas dite aktivitetin e anëtarëve të personelit të IFC-së.

Seksioni 8

Pajisjet, infrastruktura dhe vlera e mbetur

8.1 Pasuri me kosto të përbashkët. Çdo aset dhe pajisje e prokuruar nga IFC-ja si investim i përbashkët nëpërmjet buxhetit të përbashkët të IFC-së kthehet në pasuri të pjesëmarrësve dhe administrohet nga ana e IFC-së duke mbajtur një inventar të të gjitha pasurive të llogaritshme (regjistri i aseteve).

8.2 Mbas mbylljes së shtabit apo përfundimit të këtij memorandum mirëkuptimi, vlera e mbetur dhe në dispozicion e pasurisë në pronësi të përbashkët përcaktohet nga ana e SPRC-së, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e NATO-s dhe konform nenit IX të Protokollit të Parisit.

8.3 Pasuria e shtetit kuadër. Pasuria e blerë nga ana e shtetit kuadër, përveçse pasurisë me kosto të përbashkët, i përket shtetit kuadër dhe shitet sipas procedurave të tij.

8.4 Pasuria e NATO-s. Çdo pajisje e siguruar nga NATO mbetet pasuri e NATO-s dhe rishpërndahet sipas procedurave standarde të saj dhe Protokollit të Parisit.

Seksioni 9

Shërbimet mbështetëse

9.1 Anëtarët e personelit të IFC-së të pjesëmarrësve dhe personat në ngarkim të tyre do të gëzojnë komoditetet e çlodhjes, që i përkasin palës kuadër, në varësi të disponueshmërisë dhe në përputhje me kufizimet e vendosura nga pala kuadër.

9.2 Anëtarët e personelit të IFC-së, përfshirë strukturën mbështetëse kombëtare dhe personat në ngarkim të tyre, gëzojnë të drejtat dhe privilegjet e akorduara personelit të një shtabi ushtarak ndërkombëtar.

Anëtarët e pjesëmarrësve, përfshirë strukturën mbështetëse kombëtare dhe personat në ngarkim të tyre, do të sigurojnë kujdesin e tyre shëndetësor, dental, strehimin dhe edukimin e personave në ngarkim, përveçse kur lejohet ndryshe në bazë të marrëveshjeve të tjera të aplikueshme, ekzistuese bilaterale dhe multilaterale.

9.3 Çdo detyrim për shërbimet dhe pajisjet e shtetit kuadër dhe shtetit pritës do të shprehen dhe faturat do të përcaktohen në monedhën e shtetit kuadër apo shtetit pritës.

Seksioni 10 Shpenzimet

10.1 Secili pjesëmarrës do të mbulojë, si më poshtë:

a) Shpenzimet e udhëtimit të anëtarëve të tyre që lindin në fillim dhe në fund të periudhës së detyrës pranë IFC-së;

b) Rrogat, kuotat dhe shpenzimet ditore të personelit të tyre;

c) Shpenzimet e udhëtimit të autorizuara në bazë të rregulloreve kombëtare që lidhen me udhëtimet e përkohshme të punës (d.m.th. shpenzime ditore) do të mbulohen nga ana e pjesëmarrësit të cilit i përket personi që udhëton përkohësisht për qëllime pune;

d) Çdo pajisje apo personel i paraqitur pranë IFC-së nga ana e pjesëmarrësit, përveç atyre të siguruar nga ana e shtetit kuadër;

e) Sistemet e komunikimit dhe informimit që dalin nga kërkesat e tyre kombëtare;

f) Koston shtesë të çdo pajisjeje apo ambienti të veçantë që nevojitet për të përmbushur nevojat e tyre kombëtare (përfshirë godina, ambiente sportive dhe çlodhjeje) dhe çdo shpenzim tjetër operues që mund të identifikohet më vete nga ana e shtetit kuadër.

10.2 Në bazë, rast pas rasti, aplikimi për financim të përbashkët të NATO-s mund të realizohet nga ana e përgjegjësit të IFC-së nëpërmjet komandës përkatëse strategjike drejtuar komiteteve financiare të NATO-s për t'u marrë në konsideratë në përputhje me politikat dhe rregulloret në fuqi në momentin e aplikimit.

10.3 Kriteret e pranueshmërisë për financimin e dislokimit të NATO-s, në mbështetje të operacioneve të miratuara nga NAC, detajohen në MC 317 dhe PO(2005)98. Kur vendoset për pranueshmërinë, financimi i dislokimeve të veçanta mbështetëse dhe shpenzimet e veçanta që lidhen me dislokimin sigurohen nëpërmjet komitetit përkatës strategjik në kontekstin e buxheteve të OPLAN (ose alokimeve të tyre) të miratuara nga ana e komitetit përkatës financiar.

10.4 Shpenzimet e udhëtimeve (përfshirë ato ditore) të përkohshme, për efekt pune të kryera në emër të IFC-së të cilat nuk janë paguar nga fondi i përbashkët i NATO-s, do të paguhën nga buxheti i përbashkët i IFC-së.

10.5 Shpenzimet e miratuara buxhetore për IFC-në do të paguhën nga pjesëmarrësit, në përputhje me seksionin XI të këtij memorandumi mirëkuptimi. Shpenzime të tilla mund të përfshijnë mjetet e komunikimit, trajnimet dhe udhëtimet e organizuara nga ana e IFC-së (përfshirë ato ditore), shërbime komunale, furnizime, kërkesa të përgjithshme në mbështetje të zyrave, ndryshime dhe modifikime të pajisjeve, ruajtjen dhe riparimin e pajisjeve, hedhjen e mbeturinave, dezinfektimin dhe zëvendësimin apo marrjen/dhënien me qira apo hua të pajisjeve të siguruar nga ana e shtetit kuadër mbas krijimit. Shpenzime shtesë përtej shtrirjes së autoritetit, të siguruar në buxhetet e miratuara, duhet të autorizohen paraprakisht nga SPRC.

10.6 Lidhja me komandën e NATO-s dhe rrjetet e kontrollit, mjetet e komunikimit dhe qarqet e të dhënave, të përcaktuara si mision themelor, do të financohen sipas MC 317 dhe dokumentacionit tjetër përkatës të NATO-s. IFC-ja do të përdorë sisteme dhe strukturë standarde të informimit për të garantuar që mbështetja e informimit të IFC-së së saj të shtrihet në të gjitha qendrat si ato statike, ashtu edhe ato të dislokuara.

10.7 Çdo shpenzim tjetër i përgjithshëm, jo brenda kategorive të mësipërme, por që i atribuohet operimit të IFC-së, do të ndahet ndërmjet pjesëmarrësve në përputhje me seksionin XI të këtij memorandumi mirëkuptimi.

10.8 As shteti kuadër, as shteti pritës, as edhe pjesëmarrës të tjerë nuk përfitojnë të ardhura nga aktivitetet zyrtare të IFC-së.

Seksioni 11

Financimi i përbashkët (buxheti shumëkombësh)

11.1 Pjesëmarrësit do të financojnë ndërmjet tyre shpenzimet e miratuara të SPRC-së të ndashme ndërmjet pjesëmarrësve sipas pjesës aktuale të alokimit në kohë paqeje të anëtarëve të personelit të IFC-së siç reflektohet në aneksin B.

11.2 Pozicionet e paplotësuara nuk do të reduktojnë ndarjen e shpenzimeve për vendin e përcaktuar sipas paragrafit 11.1.

11.3 Shtesat e përkohshme (p.sh. stërvitje, trajnim etj.) nuk do të ndikojnë mbi pjesën e shpenzimeve kombëtare.

Seksioni 12

Pretendimet

12.1 Pretendimet do të trajtohen sipas nenit 8 të NATO SOFA dhe nenit 6 të Protokollit të Parisit.

12.2 Përveçse kur parashikohen në nenin 8 të NATO SOFA dhe/ose në nenin 6 të Protokollit të Parisit, pretendimet dhe shumat për t'u paguar që rrjedhin nga pretendimet që u përkasin aktiviteteve zyrtare të IFC-së apo personelit të saj do të ndahen ndërmjet pjesëmarrësve, sipas seksionit XI të këtij memorandumi mirëkuptimi.

Seksioni 13

Procedurat financiare

13.1 Fondet e siguruar nga pjesëmarrësit dhe rregulloret, dhe procedurat financiare të parashikuara do të jenë në përputhje me rregulloret financiare ekzistuese të NATO-s dhe rregulloret dhe procedurat zbatuese të përcaktuara si të tilla dhe të realizueshme nga SPRC.

13.2 Fondet e vëna në dispozicion nga burimet e NATO-s do të kërkohen dhe konsiderohen sipas procedurave standarde të NATO-s të përcaktuara në direktivën ACO apo siç parashikohen nga kontrolluesi financiar i ACO-së.

13.3 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

13.4 Projektbuxheti që tregon shpenzimet e parashikuara do të përgatitet dhe paraqitet pranë SPRC-së nga ana e përgjegjësit të IFC-së në datën e përcaktuar prej SPRC çdo vit për vitin e ardhshëm financiar. Në të njëjtën kohë, përgjegjësi i IFC-së do të paraqesë gjithashtu një plan financiar afatmesëm për 5 vjet në vijim të vitit të ardhshëm financiar për qëllime planifikuese. Projektbuxheti do të shqyrtohet nga SPRC-ja dhe miratohet para vitit financiar vijues. Nëse lind nevoja, gjatë periudhës së vitit financiar, për shkak të pamjaftueshmërisë të fondeve buxhetore të miratuara, përgjegjësi i IFC-së mund të paraqesë një buxhet shtesë për t'u marrë në konsideratë nga SPRC-ja.

13.5 Në përputhje me buxhetin e miratuar, përgjegjësi i IFC-së zakonisht paraqet një ftesë për fonde (FPF) çdo vit, për t'u paguar nga pjesëmarrësit sipas kushteve të vendosura nga SRPC-ja. Çdo shumë financiare për t'u paguar nga pjesëmarrësit do të vlerësohet në ftesat për fonde përkatëse. Shumat për t'u paguar livrohen falas, në monedhën britanike paund/stërлина, pranë llogarisë bankare të përcaktuar nga ana e përgjegjësit të IFC-së. Nëse një buxhet shtesë aprovohet më pas nga SPRC-ja, mund të nxirret një ftesë e dytë për fonde.

13.6 Përgjegjësi i IFC-së do të paraqesë pranë SPRC-së një deklaratë përfundimtare të llogarisë brenda 31 marsit të vitit pasues. Deklarata e llogarive përfundimtare do të paraqitet pranë SPRC-së për miratim.

13.7 Përgjegjësia financiare e pjesëmarrësve sipas këtij memorandumi mirëkuptimi i nënshtrohet autorizimit dhe përvetësimit të fondeve sipas ligjeve përkatëse kombëtare.

13.8 Agjencia e preferuar për auditimin është bordi ndërkombëtar i auditorëve për NATO-n (BNAN). Megjithatë, auditimet do të realizohen sipas autorizimeve të SPRC-së.

13.9 Pjesëmarrësit gëzojnë të drejtën për të përdorur çdo të dhënë të nevojshme mbi kontributin e tyre kundrejt financimit të përbashkët të IFC-së për qëllime auditimi.

Seksioni 14

Siguria dhe mbrojtja e forcës

14.1 Siguria e jashtme do të sigurohet nga shteti kuadër ose pala kuadër sipas rastit.

14.2 Siguria e brendshme mbetet përgjegjësi e përgjegjësit të IFC-së që vepron sipas rregulloreve aktuale të sigurisë.

14.3 Pjesëmarrësit do të ruajnë sigurinë e çdo të dhëne të klasifikuar të siguruar gjatë periudhës së misionit të IFC-së sipas rregullave dhe rregulloreve të sigurisë jo më pak të rrepta sesa ato të parashikuara për të dhënat e klasifikuara të NATO-s në CM (2002)-49, përfshirë të gjitha shtesat dhe ndryshimet e tyre dhe në përputhje me marrëveshjet dhe masat ekzistuese të sigurisë.

14.4 Në rastin e përfundimit të këtij memorandumi mirëkuptimi apo tërheqjeje prej tij, pjesëmarrësit do të garantojnë që dispozitat që lidhen me sigurinë, nxjerrjen e të dhënave dhe konfidencialitetin të mbeten në fuqi.

14.5 Dispozitat e mëtejshme do të përcaktohen në marrëveshjen teknike siç përmendet në seksionin III, paragrafi 3.2.

14.6 Anëtarët e IFC do të përmbushin kërkesat për certifikatë sigurie sipas përshkrimit të detyrës së IFC-së.

14.7 Secili pjesëmarrës do të garantojë që anëtarët e personelit të IFC-së të pajtohen me procedurat e sigurisë së IFC-së në çdo rast. Çdo shkelje e procedurave të sigurisë nga ana e anëtarëve të personelit të IFC-së gjatë detyrës së tyre do t'i raportohet pjesëmarrësit për të ndërmarrë veprimin e duhur sipas CM (2002)-49, AC/35-D/2002 dhe AD 65-3.

Seksioni 15

Komiteti i Lartë i Politikave dhe Burimeve

15.1 Përfaqësuesit e përcaktuar të nënshkruesve do të përbëjnë Komitetin e Lartë të Politikave dhe Burimeve/Senior Policy and Resource Committee (SPRC), i cili do të funksionojë sipas termave të referencës në aneksin C. Pjesëmarrësit do të garantojnë përfaqësimin në takimet e SPRC-së me autoritetin e duhur për të diskutuar dhe marrë vendime mbi politikën, plotësimin me personel dhe/ose çështjet financiare sipas nevojës, bazuar në rendin e ditës të secilit takim.

Seksioni 16

Hyrja në fuqi, tërheqja, kohëzgjatja, ndryshimi, pjesëmarrja dhe përfundimi

16.1 Ky memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e fundit të nënshkrimit të shtetit kuadër, shtetit pritës dhe SHAPE, dhe, për sa u përket të gjithë pjesëmarrësve të tjerë, në datën e nënshkrimit të secilit pjesëmarrës tjetër të tillë (ose në datën e njoftimit të miratimit në rastin kur nënshkrimi i nënshtrohet miratimit pasues). Dispozitat financiare, lidhur me financimin e përbashkët, do të hyjnë në fuqi më 1 janar 2007.

16.2 Çdo nënshkrues që dëshiron të tërhiqet nga ky memorandum mirëkuptimi, duhet t'i njoftojë me shkrim 12 muaj më parë të gjithë nënshkruesit e tjerë. Në këtë rast, nënshkruesit e mbetur dhe/ose pjesëmarrësit do të takohen për të diskutuar rishpërndarjen e shpenzimeve të përbashkëta, financimin dhe pozicionet vakante.

16.3 Në rast se një pjesëmarrës tërhiqet nga ky memorandum mirëkuptimi dhe në rast se pjesa e tij nuk merret përsipër nga një pjesëmarrës tjetër, ai:

a) do të vazhdojë të mbështesë IFC-së deri në fund të periudhës së njoftuar, përfshirë pagesën e pjesës së tij të buxhetit të miratuar deri në fund të vitit financiar në të cilin përfundon periudha e njoftuar;

b) do të rimbursohet për vlerën e mbetur të të gjitha investimeve, për të cilat ka kontribuar në masën në të cilën pjesa e tij është marrë përsipër nga një pjesëmarrës tjetër siç është rënë dakord me pjesëmarrësit e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në rast se pjesëmarrësi që tërhiqet nuk rimbursohet në momentin e tërheqjes, ai e ruan pretendimin e tij ndaj vlerës së mbetur deri në momentin kur një pjesëmarrës tjetër të marrë përsipër pjesën e tij dhe të paguajë kompensimin për të ose deri në momentin kur investimi të jetë shlyer plotësisht.

16.4 Secili nënshkrues i këtij memorandum mirëkuptimi mund të propozojë ndryshime të çdo dispozite të tij. Çdo ndryshim i tillë do të hyjë në fuqi, kur të pranohet me shkrim nga të gjithë nënshkruesit e këtij memorandum. Ndryshimet ndaj anekseve nga B deri në F të këtij memorandum mund të arrihen me miratimin njëzëri të SPRC-së. Gjatë procesit të ndryshimit apo rishikimit të miratimit, palët do të vazhdojnë të plotësojnë përgjegjësitë e tyre sipas këtij memorandum mirëkuptimi.

16.5 Pjesëmarrja në IFC është hapur për çdo anëtar të NATO-s, me kusht që anëtari të pranojë kushtet e arsyeshme dhe të barabarta të vendosura nga pjesëmarrësit. Aplikimi për të marrë pjesë në memorandumin e mirëkuptimit mund të kryhet në çdo moment. Çdo aplikim i ri do t'u rekomandohet nënshkruesve nga ana e SPRC-së.

a) Kontributi i plotë i secilit shtet aplikant do t'i nënshtrohet gjykimit dhe bisedimeve të SPRC-së. Kontributi financiar do jetë konform parimeve të ndarjes së shpenzimeve të këtij memorandum mirëkuptimi.

b) Një njoftim për anëtarësim do të realizohet ndërmjet shtetit aplikant dhe nënshkruesve të këtij memorandum mirëkuptimi pranë SPRC-së. Njoftimi për anëtarësim do të vërtetojë se shteti aplikant është bërë pjesëmarrës në këtë memorandum mirëkuptimi.

c) Statusi si pjesëmarrës do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit të fundit të njoftimit për anëtarësim (të referuar në 16.5b më sipër) duke pasqyruar anëtarësimin, përveçse kur është rënë dakord ndryshe nga ana e pjesëmarrësve.

16.6 Nëse shteti kuadër njofton mbi qëllimin e tij për t'u tërhequr nga kjo marrëveshje, sipas seksionit 16.2 më sipër, ky memorandum mirëkuptimi përfundon 12 muaj mbas paraqitjes së njoftimit fillestar për t'u tërhequr.

16.7 Këtij memorandum mirëkuptimi mund t'i jepet fund me anë të pëlqimit njëzëri të nënshkruesve në çdo rast.

16.8 Shteti pritës do të njoftojë të gjithë nënshkruesit e tjerë me shkrim 12 muaj para, nëse planifikon ta mbyllë RAF Molesworth.

Seksioni 17 Mosmarrëveshjet

17.1 Çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin apo implementimin e këtij memorandum mirëkuptimi do të zgjidhet me anë të këshillimit, ndërmjet nënshkruesve. Mosmarrëveshjet të cilat nuk mund të zgjidhen me anë të këshillimit, do t'i përcillen komitetit ushtarak ose një autoriteti tjetër të duhur të NATO-s për një zgjidhje përfundimtare, duke marrë në konsideratë dispozitat e konstatuara në NATO SOFA dhe Protokollin e Parisit. Mosmarrëveshjet që lidhen me këtë memorandum mirëkuptimi nuk do t'i përcillen asnjë organizate, gjykate apo arbitri tjetër të jashtëm qofshin ndërkombëtarë, apo të brendshëm.

Sa më sipër, përfaqëson mirëkuptimet e arritura ndërmjet nënshkruesve mbi çështjet e referuara në këtë memorandum.

Ky memorandum mirëkuptimi është hartuar dhe nënshkruar vetëm në gjuhën angleze. Origjinali do të depozitohet pranë operacioneve të Komandës Aleate, e cila do t'ua përcjellë një kopje të vërtetuar nënshkruesve dhe IFC.

Për Ministrin e Mbrojtjes të Mbretërisë së Belgjikës
_____ Nënshkrimi _____ data: 5 tetor 2006
Francis Massaux
Gjeneral Brigade
Përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar i Belgjikës

Për Departamentin e Mbrojtjes Kombëtare të Kanadasë
_____ Nënshkrimi _____ data: 5 tetor 2006
Christopher J. Henneberry
Kolonel
Përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar i Kanadasë

Për Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës Çeke
_____ Nënshkrimi _____ data: 5 tetor 2006
Hynek Blasko
Gjeneral Major
Përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar i Republikës Çeke

